

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS “PSIKOLOGJI”**



Program orientues

**Koordinator:
Esion Zgjana**

2025-2026

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML.....	16
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	23
Model ore mësimore për nivelin AML.....	24
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	32
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	40
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AML	42
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	49

HYRJE


Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtjesore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Një mësues i aftë mund t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të menduar logjikisht dhe për të zbërthyer problemet në hapa të qartë. Mësuesi duhet të jetë i aftë të përdorë metoda të ndryshme për të shpjeguar konceptet e vështira. Kjo mund të përfshijë përdorimin e mjeteve vizuale, shembujve praktikë apo aplikimeve në jetën reale që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet abstrakte. Një mësues i mirë e di se duhet të fillojë nga bazat dhe të krijojë një strukturë logjike për të avancuar me koncepte më të përparuara. Kjo siguron që nxënësit të kenë një themel të fortë dhe të mos ndihen të mbingarkuar. Një mësues i mirë i psikologjisë mund të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në fusha të caktuara dhe të japë mbështetje shitesë për ta.

Mësuesi mund të përfitojë nga përdorimi i programeve kompjuterike, aplikacioneve dhe platformave edukative që ndihmojnë nxënësit të praktikojnë konceptet dhe të zgjidhin probleme me ritmin e tyre.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës



mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;

- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së psikologjisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së psikologjisë për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë rritje më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, qasjen STEM etj.;
- të tregojë përgjegjëshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësi shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e psikologjisë në *arsimin e mesëm të lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, tre modele orësh mësimore për lëndën e psikologjisë në nivelin arsimor *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, katër modele projektesh kurrikulare për lëndën e psikologjisë në nivelin arsimor *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore të psikologjisë;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës së psikologjisë;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të psikologjisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAMI LËNDOR I PSIKOLOGJISË”

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programit të psikologjisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i psikologjisë:</i> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, tematikash, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e psikologjisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.	• Korniza Kurrikulare. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX. • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT
TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e psikologjisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i psikologjisë:</i> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së psikologjisë; • edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së psikologjisë; • motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018.

Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e psikologjisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i psikologjisë:</i> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithë përfshirjen; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një testi.	• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së psikologjisë në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së psikologjisë në arsimin e mesëm të lartë. • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, Lënda: psikologji. Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP, Lënda: psikologji.
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në psikologji”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i psikologjisë:</i> • prezanton materiale të lëndës së psikologjisë duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word;	• Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së psikologjisë klasa e XII e arsimit të mesëm të lartë, që kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.

• nxënës të bëjnë prezantime në psikologji duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënës në projekte kurrikulare të lëndës së psikologjisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.	• Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. • Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP. • Udhëzimi për vlerësimin ndërkombëtar PISA, ASCAP.
--	---

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i psikologjisë:</i> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i psikologjisë:</i> - njih rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; - demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së psikologjisë”	
Mësuesi i psikologjisë: - përshkruan nën fushat kryesore të psikologjisë; - përshkruan zhvillimin e psikologjisë si një shkencë empirike; - shpjegon rëndësinë e mirëqenies shpirtërore dhe të kujdesit që i duhet kushtuar kësaj; - dallon këndvështrimet e sotme të psikologëve për kuptimin e sjelljes dhe të proceseve mendore;	Programe dhe tekste të lëndës së psikologjisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës së psikologjisë për klasën e XII të arsimit të mesëm të lartë.

- tregon veçorinë e psikologjisë në studimin e sjelljes dhe të proceseve mendore;
- vlerëson rëndësinë e funksionimit psikologjik në jetë;
- përshkruan strukturën dhe funksionim e neuronit;
- përshkruan organizimin e sistemit nervor;
- përshkruan strukturën dhe funksionimin e sistemit endokrin;
- përshkruan teoritë kryesore për motivacionin;
- shpjegon reagimet fiziologjike dhe psikologjike ndaj stresorëve;
- njeh teknologjitë dhe metodat klinike të studimit të trurit;
- shpjegon bashkëveprimin e trashëgimisë me mjedisin në lidhje me sjelljen;
- shpjegon perceptimin dhe bashkëveprimin e personit me mjedisin;
- analizon rolin e biologjisë dhe të të nxënit në motivacionin dhe emocionet;
- analizon aspektet fiziologjike, afektive, konjitive dhe sjellore të emocioneve;
- vlerëson rëndësinë e kujdesit për funksionimin mendor;
- vlerëson veprime për përmirësimin e shëndetit mendor;
- përshkruan zhvillimin si proces jetësor;
- tregon teknikat për grumbullimin e të dhënave për zhvillimin njerëzor;

- përshkruan teoritë për zhvillimin njerëzor;
- përshkruan mjetet në përdorim për vlerësimin e personalitetit;
- vlerëson periudhën personale të zhvillimit dhe rëndësinë që ka ajo për jetën;
- zhvillon sjellje të shëndetshme në lidhje me substancat, seksin, ushqimin;
- përshkruan kuptimin dhe parimet e të nxënies;
- rendit pjesët përbërëse të të mësuarit konjitiv;
- përshkruan mënyrën si bëhet regjistrimi dhe përdorimi i informacionit të kujtesës;
- përshkruan sistemet e kujtesës afatshkurtër e afatgjatë;
- rendit tiparet strukturore të gjuhës;
- përshkruan teoritë dhe stadet e zhvillimit të gjuhës;
- përshkruan natyrën e ndërgjegjes;
- përshkruan drogat psikoaktive dhe rolin e tyre në psikikë;
- përshkruan natyrën e inteligjencës dhe si testohet ajo;
- analizon marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit në diferencat individuale;
- analizon metodat e përmirësimit të kujtesës;
- shpjegon lidhjet ndërmjet të menduarit dhe gjuhës;

- njeh karakteristikat dhe teoritë e gjumit, të ëndrrave dhe të hipnozës;
- tregon pse dhe si maten veçoritë individuale;
- zgjidh probleme mbi bazën e njohurive të fituara;
- përshkruan karakteristikat dhe origjinën e sjelljes anormale;
- rendit metodat e përdorura për studimin e sjelljes anormale;
- shpjegon kategoritë kryesore të sjelljes anormale;
- përshkruan metodat më të shquara për trajtimin e sjelljes anormale;
- përshkruan kategoritë shoqërore dhe kulturore;
- zotëron njohuri se kush i trajton çrregullimet e sjelljes;
- analizon ndikimin shoqëror dhe marrëdhëniet shoqërore;
- dallon sjellje të shëndetshme mendore;
- vlerëson shëndetin mendor;
- vlerëson rolin e psikologut dhe të psikiatrit;
- demonstroi qëndrime tolerance dhe jo paragjyquese në jetën personale.

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

Model pyetjesh të lëndës “Psikologji”, AML

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Fusha e psikologjisë është shumë fleksibël, prandaj mësuesve u kërkohet që në realizimin e programit të jenë:

- A) krijues
- B) kërkues
- C) kritikë
- D) tolerantë

Pyetja 2

Përcaktimi ”Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët”, i përket kompetencës:


- A) Digjitale
- B) Qytetare
- C) Personale
- D) Të të mësuarit

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetja 3

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të mbështesë të nxënit. Ky qëllim realizohet përmes:

- A) Vlerësimit për të nxënit formues (VpN)
- B) Vlerësimit të të nxënit përmbledhës (ViN)
- C) Vlerësimit të vazhdueshëm për të nxënit.
- D) Vlerësimi i të nxënit formues i kombinuar me atë përmbledhës.



Pyetja 4

Përpara se të zhvillojë mësimin 'Teoritë e motivacionit', nxënësi duhet të njohë së pari konceptin e:

- A) Perceptimit
- B) Emocionit
- C) Motivacionit
- D) Personalitetit

Pyetja 5

Kurrikula me zgjedhje zhvillohet në të tria klasat e gjimnazit. Tregoni në cilën klasë zhvillohet lënda e Psikologjisë:

- A) Dhjetë
- B) Njëmbëdhjetë
- C) Dymbëdhjetë
- D) Dhjetë dhe të njëmbëdhjetë

Pyetja 6

Gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin në distancë roli i mësuesit është :

- A) Lehtësojë dhe të drejtojë nxënësit.
- B) Vlerësojë nxënësit bazuar në përgjigjet e tyre;
- C) Nxsis nxënësit për një pjesëmarrje më të lartë;
- D) Kontribuoj në përmirësimin e situatës.

Pyetja 7

Nxënësit zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëllime duke i demonstruar ato në mënyrë të pavarur dhe krijuese, në situata të reja dhe të panjohura për ta në nivelin :

- A) I të arritjeve
- B) II të arritjeve
- C) III të arritjeve
- D) IV të arritjeve

Pyetja 8

Vlerësimi i nxënësit është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultatit të të nxënës. Një ndër arsye se përdoret vlerësimi është:

- A) për të matur arritjet e nxënësve;
- B) për t'u treguar atyre që nuk dinë mjaftueshëm;
- C) për të kuptuar se si mund të shkojnë më tej;
- D) për të mos gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve për të nxënë.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9


Pohimi se mësuesi jep një pamje më të gjerë për konceptin e vetes, të grupeve dhe dinamikave të ndryshme që ndikojnë në sjellje ka të bëjë me standardin e:

- A) Zhvillimit të psikologjisë;
- B) Ndryshimit individual;
- C) Zbatimeve të psikologjisë;
- D) Ndikimit të kontekstit social-kulturor.

Pyetja 10

Vetëvlerësimi i mësuesit bazuar në standardet profesionale bëhet me katër nivele. Pohimi arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim i përket:

- A) Nivelit të parë
- B) Nivelit të dytë
- C) Nivelit të tretë
- D) Nivelit të katërt



D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) klasat 12-ta të shkollës
- B) klasat e 12 të shkollës
- C) klasat e 12-ta të shkollës
- D) klasat e 12-të të shkollës

Pyetja 12

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.


- A) Arësim parauniversitar
- B) Arsimë parauniversitar
- C) Arsim parauniversitar
- D) Arsimim parauniversitar

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Psikologët që mendojnë se njeriu është një qenie që përpiqet në mënyrë të vazhdueshme për t'u zhvilluar, janë të drejtimit:

- A) Psikanalitik
- B) Bihevjorist
- C) Humanist
- D) Biologjik



Pyetja 14

“Formimi psikosocial i fëmijës nga mosha 1 deri në 3 vjeç” – është një temë interesante për t’u studiuar nga një psikolog:

- A) Klinik
- B) Zhvillimor
- C) Social
- D) Edukimi

Pyetja 15

Sipas drejtimit psikoanalitik sjellja përcaktohet nga:

- A) Dëshirat e njeriut.
- B) Kërkesat e mjedisit të jashtëm.
- C) Procese të pavetëdijshme.
- D) Mënyra se si njeriu i mendon situatat.

Pyetja 16

Korrelacioni është negativ kur:

- A) Të dy faktorët ndryshojnë në të njëjtin drejtim.
- B) Një faktor ndryshon, tjetri ndryshon në drejtim të kundërt.
- C) Të dy faktorët nuk ndryshojnë.
- D) Një faktor ndryshon, faktori tjetër nuk ndryshon.

Pyetja 17

Sistemi nervor është shumë i rëndësishëm për funksionet trupore të njeriut. Evidentoni cila nga alternativat e mëposhtme është njësia bazë e sistemit nervor:

- A) Citoplazma
- B) Neuroni
- C) Nervat
- D) Dentritet

Pyetja 18

Tregoni cilat nga ndijimet e mëposhtme janë të zhvilluara më mirë tek i porsalinduri:

- A) Nuhatja dhe shikimi.
- B) Dëgjimi dhe shikimi.
- C) Nuhatja dhe shijimi.
- D) Dëgjimi dhe shijimi.

Pyetja 19

Një fëmijë po luan me kukullën e saj. Gjyshja ia merr dhe e fsheh, duke i thënë që nuk është më. Fëmija kërkon diçka tjetër për të lozur. Bazuar tek situata e mësipërme fëmija nuk ka zhvilluar akoma konceptin e:

- A) Ruajtjes së objektit.
- B) Vazhdimësisë së objektit.
- C) Mos ekzistencës së objektit.
- D) Fshehjes së objektit.

Pyetja 20


Cili nga pohimet e mëposhtme përfaqëson konceptin e kompliancës:

- A) Sjellja sipas midesë së grupit.
- B) Dorëzimi para kërkesave të tjerëve.
- C) Zbatimi i urdhrave.
- D) Mesazhi efikas.

Pyetja 21

Andi është duke bashkuar pjesët e njëjta të një objekti me qëllim që të përfitojë një figurë të caktuar. Tregoni cili parim të organizimit perceptues është duke përdorur:

- A) afërsinë
- B) ngjashmërinë
- C) vazhdimësinë
- D) ndërprejen



Pyetja 22

Sipas Frojdit, ajo pjesë e mendjes që ruan informacionin që ne kemi mësuar është:

- A) Vetëdija
- B) Para vetëdija
- C) Pavetëdija
- D) Asimilimi

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përse i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënit dhe përshtaten me stilet e të nxënit dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxëni efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënit që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur tre modele orësh mësimore për lëndën e matematikës në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për nivelin AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënës, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

A. Model ore mësimore 1 në lëndën e “Psikologjisë” AML

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Psikologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Rruga e sinjaleve nga mjedisi në trurin tonë		Situata e të nxënës: Çfarë ndodh kur ju jeni duke u përgatitur të bëni një dush dhe fusni dorën në ujë për të marrë vesh nëse është i ngrohtë apo i ftohtë, sa duhet për ju? Pse pirja e kafesë e bën njeriun nervoz? Sa duhet ta ngrejë zërin mësuesi në mënyrë që ta dëgjojë edhe nxënësi i fundit?	
Rezultatet e të nxënës (bazuar në programin lëndor): <i>Nxënësi në fund të orës së mësim:</i> • përshkruan rrugën që bën sinjali nga mjedisi i jashtëm në trurin tonë. • shpjegon rëndësinë që ka forma e molekulës së një neurotransmetuesi për zonën marrëse të një dentriti. • analizon efektet dhe rolin që realizojnë neurotransmetuesit në organizmin tonë.		Fjalët kyçe: neuron, akson, dendrite, sinaps, neurotransmetues, dopaminë.	
Burimet: teksti i nxënësit, flipchart; tabletë; projektor; tabelë elektronike.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi, Fizikë	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Organizimi i orës së mësimi.

Parashikimi i njohurive:

Në bashkëpunim me nxënësit bëhet një përmbledhje e koncepteve kryesore të kapitullit “Studimi i psikologjisë”. Mësuesi/ja nxit nxënësit të kujtojnë:


- *Cili është objekti i psikologjisë?*
- *Drejtimit kryesore të psikologjisë.*
- *Roli dhe puna e psikologëve.*
- *Metodat e studimit në psikologji.*

Zhvillohet një diskutim rreth tyre me përgjigjet që nxënësit plotësojnë dhe prezantojnë duke paraqitur informacionin që diskutuan në tabelë.

Ndërtimi i njohurive:

Përgjigjet e pyetjeve të mësipërme integrohen me informacionin e ri mbi bio psikologjinë.

Bio psikologjia merret me marrëdhëniet midis organizmit njerëzor dhe jetës së tij shpirtërore.



U tregohet në ekran metoda e zakonshme e funksionimit të qelizës nervore, që është:

- a. dendritet marrin informacione, i dërgojnë ato në trupin e qelizës: ato janë marrëse;
- b. trupi i qelizës neurale i dërgon ato përmes aksonit në një neuron tjetër, i cili duhet ta përcjellë këtë informacion më tej deri në sistemin nervor: aksonet janë përcjellëse.

Ilustrohet me shembuj mënyra e ndërtimit të neuronit dhe udhëtimi i informacionit nga një neuron në tjetrin (duke përdorur njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e biologjisë për këtë temë).

Neurotransmetuesit dhe roli i tyre

Mendohet se neurotransmetuesit realizojnë dy efekte, efektin eksitues dhe efektin frenues.

Efekti *eksitues*: nëse neurotransmetuesi është i tillë, ai ka fuqi depolarizuese, pra ul ngarkesën elektrike të membranës së neuronit të dytë dhe kështu e elektrizon atë. Pasoja e kësaj është mundësia që informacioni të shkojë më tej.

Efekti *frenues*: në këtë rast neurotransmetuesi shton ngarkesën negative të membranës qelizore të neuronit të dytë, duke e bërë më të vogël mundësinë që ai të elektrizohet. Në rastin e dytë informacioni ndalohej të shkojë më tej.

Dopamina. Në një rajon të trurit që merret me lëvizjet trupore që ne kryejmë ndodhet një zonë ku prodhohet neurotransmetuesi me emrin dopaminë. Nëse kjo zonë dëmtohet, atëherë ndodh që të shfaqet një sëmundje që quhet Sëmundja Parkinson.

U kërkohet nxënësve të konkretizojnë me shembuj rolin e dopaminës dhe sëmundjet që shkaktohen nga dëmtimi i kësaj zone të trurit.

Diskutohet rreth rolit që luan shkenca në studimin e trurit dhe rreziqet që na vijnë nga dëmtimi i tij.

Përforcimi i të nxënit:

U kërkohet nxënësve të nxjerrin nga teksti të gjitha konceptet kryesore dhe u shtroj pyetjen:

Cila është risia me të cilën trajtohen këto koncepte në këtë tekst, ndryshe nga lëndë të tjera si p.sh. biologjia?

Përfundimet paraqiten në tabelë.

Vlerësimi: Teknikat e vlerësimit që përdoren gjatë kësaj ore janë: vlerësim me gojë (të pyeturit, diskutimi, prezantimi etj.), vlerësim përmes detyrave krijuese, vetëvlerësim, vlerësim të nxënësit nga nxënësi, mënyra e formulimit të konkluzioneve.

Vlerësimi do të mbështetet mbi nivelet e arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në këtë temë:

Niveli 2: *përshkruan* rrugën që bën sinjali nga mjedisi i jashtëm në trurin tonë;

Niveli 3: *analizon* rëndësinë që ka forma e molekulës së një neuro transmetuesi për zonën marrëse të një dentriti;

Niveli 4: *gjykon* efektet dhe rolin që luajnë neuro transmetuesit në organizmin tonë.

Detyra: Sipas nevojave të nxënësve dhe stileve të të nxënës mësuesi jep udhëzimet për detyrat.

Vizatoni procesin elektrik në qelizën nervore. Diskutojeni atë me mësuesin e fizikës.

B. Model ore mësimore 2 në lëndën e “Psikologjisë” AML

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Psikologji	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Zhvillimi gjatë adoleshencës		Situata e të nxënit: Ndryshimet e dekadës së dytë të jetës janë dramatike nga pikëpamja e përmbajtjes dhe e intensitetit. Ndryshimet janë fizike: gjymtyrët rriten me shpejtësi, vajzat hedhin shtat më shpejt se djemtë, megjithatë aty nga mosha 16-17 vjeç vajzat arrijnë gjatësinë e plotë ndërsa djemtë aty nga mosha 18-20 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (bazuar në programin lëndor): <i>Nxënësi në fund të orës së mësimi:</i> - përshkruan disa zhvillime fizike, psikologjike, morale e sociale të adoleshencës. - analizon disa prej kontradiktave brenda së cilave jetojnë adoleshentët. - ilustron me shembuj shkaqet e konflikteve të adoleshentëve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit.		Fjalët kyçe: identitet, protestë, konflikt, konfuzion.	
Burimet: libri i nxënësit; libri i mësuesit; tablete, tabele interaktive ose video projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Sociologji, Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizim i orës së mësimi

Parashikimi i njohurive:

Bëhet një përmbledhje e koncepteve kryesore për zhvillimin fizik, njohës dhe moral të fëmijës.

U kërkohet nxënësve të:

- Përshkruajnë zhvillimin e nipit, mbesës 4-5 vjeç.
- Përshkruajnë zhvillimin mendor të një të afërmi në moshën e fëmijërisë.
- Komentojnë për zhvillimin moral të një të afërmi në moshën e fëmijërisë.

Zhvillohet një diskutim rreth tyre me përgjigjet që nxënësit plotësojnë dhe prezantojnë duke paraqitur informacionin që diskutuan në tabelë.

Pas përgjigjeve për zhvillimin e fëmijës, u kërkohet nxënësve që të përshkruajnë veten e tyre, në moshën e adoleshencës.

Ndërtimi i njohurive:

Informacioni i dhënë nga nxënësit bashkohet me informacionin e ri. Në këtë moshë ata i drejtojnë pyetje vetes:

“A kam formën e duhur të trupit, si të duket ty?”; “A eci si duhet, ç’thonë të tjerët për ecjen time?”; “Nuk ndenjën që nuk ndenjën si duhet këto flokët e mia!”.

Në moshën e adoleshencës ndodhin ndryshime të shumta:

- a) Ndryshimet fiziologjike kanë të bëjnë me zhvillimin e shenjave primare dhe sekondare të seksit.
- b) Ndryshimet e tyre janë kognitive: adoleshenti në moshën 11- 12 vjeç arrin të mendojë në mënyrë abstrakte, pra të shkojë përtej asaj që kapin shqisat; të mendojë në mënyrë logjike, pra të përdorë disa fakte e ide për të dalë në përfundime të tjera.
- c) Adoleshentët pësojnë edhe një zhvillim të madh moral: ata tani zakonisht nuk konfirmohen lehtë dhe kanë moralin e vet autonom. Ata fillojnë të zbulojnë defekte në sjelljen e prindërve të tyre.

d) Nga ana shoqërore adoleshenti është në përpjekjet për të formuar identitetin personal, për të lidhur dhe për të mbajtur shoqëritë e krijuara.

Në bashkëpunim me nxënësit diskutohet se çmendojnë adoleshentët për veten e tyre.

Pyetje: A është adoleshenca një moshë e vështirë?

Pas njohjes me informacionin e ri, analizohen problematikat që hasin adoleshentët në komunikimin me të rriturit.

Çfarë e bën të vështirë këtë gjë?

1. Adoleshentet jetojnë nën presionin e forcave kontradiktore;
2. Mësuesit e prindërit në veçanti, e shohin dhe e trajtojnë adoleshentin në mënyrë të njëanshme, si një qenie “me shtatin pyll dhe mendjen fyell”;
3. Zhvillimi i adoleshenteve karakterizohet nga shpërpjesëtime të rëndësishme;
4. Brezi i rritur ka ankesa dhe kritika ndaj disa sjelljeve të adoleshentëve;
5. Adoleshenti proteston dhe rebelon ndaj dominimit prindëror ose përpiqet t’i shmanget atij.

Përfundimet shënohen në tabelë.

Përforcimi i të nxënit:


U kërkohet nxënësve të hartojnë një ese mbi vështirësitë e tyre si adoleshent si adoleshent.

Përpiquni të aplikoni në interpretimin tuaj teorinë e Piazhësë, të Eriksonit dhe të Kolbergut.

Vlerësimi: Teknikat e vlerësimit që përdoren gjatë kësaj ore janë: vlerësim me gojë (të pyeturit, diskutimi, prezantimi etj.) vlerësimi i punës në grup, vlerësim përmes detyrave krijuese, vetëvlerësim, vlerësim të nxënësit nga nxënësi, mënyra e formulimit të konkluzioneve.

Vlerësimi do të mbështetet mbi nivelet e arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në këto tema:

Niveli 2: përshkruan disa zhvillime fizike, psikologjike, morale e sociale të adoleshencës.



Niveli 3: *analizon* disa prej kontradiktave brenda së cilave jetojnë adoleshentët;

Niveli 4: *ilustron* me shembuj shkaqet e konflikteve të adoleshentëve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;

Detyra: Sipas nevojave të nxënësve dhe stileve të të nxënit mësuesi jep udhëzimet për detyrat. Hartoni një ese mbi zhvillimin moral të njërit prej shokëve tuaj. Kujdesuni të jeni sa më specifik në informacionet dhe në analizat që do të bëni. Veçoni ato sjellje që janë karakteristike për të.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore:

- mbështesin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënës.	Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënës (RN) nuk bazohen në programin lëndor Metodologjia është	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënës (RN) ose	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e

	tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësve. Pyetjet që janë planifikuar nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.	nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i klasës është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënësve. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënësve dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.	Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.	Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke	Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe

			<i>lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënës gjatë gjithë jetës.</i>	<i>rezultate të kompetencave kyç të të nxënës gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënës (6 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënës të trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, por jo të gjithë nxënës të kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përshihen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënës të nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënës të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënës duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përshin të gjithë nxënës duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përshihen.</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënës të përshihen dhe</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënës të përshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënës të përshihen dhe angazhohen me detyra motivuese</i>

iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
--	---	--	---	---

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdori ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, por vetëm disa</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdori metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, që</i>
---	---	---	--	--

	<i>Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësimi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>nxisin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe llojeve të ndryshme dhe llojeve të ndryshme. Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk u jep mundësi</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</i>

	<i>nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	
Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)				
Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimi. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi e përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstron se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës</i>	<i>Mësuesi demonstron se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstron se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga</i>

			<i>mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve.	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjetet mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk i angazhon shumë nxënës në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjetet mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënës në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te ata të</i>

				mësuarin praktik dhe krijues.
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore,</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënësve nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësve në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme



nga puna e secilit nxënës.

- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AML

A. Model 1 i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit: " Zhvillimi nga fëmijëria e më tej "

Kohëzgjatja: 5 orë, (të planifikuara të planifikuara 1 orë për periudhën e I, 1 orë për periudhën e II, 3 orë për periudhën e III).

Klasa: XII

Rezultatet e të nxënës: Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi zbaton aftësitë e vlerësimit të diversitetit dhe tolerancës, të ndërveprimit dhe bashkëpunimit me të tjerët, të analizës së të dhënave dhe përpunimit statistikor për të eksploruar teoritë e ndryshme të zhvillimit të njeriut, për të kuptuar rëndësinë e tyre dhe për të propozuar zgjidhje të mundshme për probleme të ndryshme.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- fazat e ndryshme të zhvillimit si dhe teoritë e zhvillimit;
- si ka ndryshuar zhvillimi dhe kujdesi për zhvillimin e moshave të ndryshme në kohë;
- pyetësi, intervista, anketa, kampionimi;
- grumbullimi i të dhënave;
- përpunimi i të dhënave;
- tabelat, diagramet,
- paraqitja grafike e të dhënave;
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

Partnerët: target e individëve që do të anketohen.

Burimet kryesore të informacionit: anketa, intervista, pyetësorë, materiale nga interneti, literaturë psikologjike

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:


- Përzgjedhja e temës, diskutimi
- Hulumtimi mbi temën

- Mbledhja e të dhënave
- Analiza e të dhënave
- Prezantimi i të dhënave
- Diskutim dhe Reflektim

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Prezantoni nxënësit çështje të ndryshme sociale, si pabarazia në të ardhura, varfëria, ndryshimet klimatike ose pabarazitë arsimore.
- Kërkojuni nxënësve të zgjedhin një çështje të zhvillimit me interes dhe të kryejnë kërkime për të mbledhur të dhëna dhe informacione përkatëse rreth çështjes. Ata duhet të marrin parasysh shkaqet, ndikimet dhe zgjidhjet e mundshme që lidhen me temën e zgjedhur.
- Udhëzoni nxënësit për metodat e mbledhjes së të dhënave, të tilla si anketat, intervistat ose bazat e të dhënave në internet, literaturë psikologjike, studime të ngjashme të realizuara më parë, për të mbledhur të dhëna në lidhje me çështjen e zgjedhur.
- Udhëzoni nxënësit në organizimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura duke përdorur teknika statistikore. Ata mund të përdorin mjete të tilla si, softuer të analizës statistikore, etj.
- Nxitini nxënësit të përdorin paraqitjet e duhura vizuale e analitike për të theksuar modelet, prirjet ose marrëdhëniet në të dhëna.
- Nxënësit përgatisin prezantime për të ndarë kërkimet e tyre, analizën e të dhënave dhe zgjidhjet e propozuara me klasën ose një audiencë më të gjerë, si p.sh. përmes një simpoziumi.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për trajtimin e çështjes së studiuar.
- Nxitini nxënësit të reflektojnë mbi të nxënit e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit: Inkurajoni nxënësit të zhvillojnë dhe zbatojnë një plan veprimi në lidhje me çështjen e zhvillimit që ata hetuan. Kjo mund të përfshijë rritjen e ndërgjegjësimit, organizimin e fushatave për informim, etj. Nxënësit dokumentojnë veprimet e tyre dhe reflektojnë mbi ndikimin që kanë bërë në trajtimin e temës së studiuar.



Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer për çështjen e hulumtuar.
- ***Analiza dhe interpretimi i të dhënave:*** Saktësia dhe përshtatshmëria e teknikave të përdorura për të analizuar të dhënat e mbledhura.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e analizës, vlerësimi i zgjidhjeve të problemeve të mundshme dhe reflektimi mbi veprimet personale të ndërmarra.

B. Model 2 i një projekti kurrikular për nxënësit në AML

Tema e projektit “Ndikimi i mjedisit në formimin e sjelljeve dhe qëndrimeve.”

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 5 orë mësimore (të planifikuara 1 orë për periudhën e I, 1 orë për periudhën e II, 3 orë për periudhën e III).

Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa XII

Rezultatet e të nxënësve – Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi zbaton aftësitë e vlerësimit të diversitetit dhe tolerancës, të ndërveprimit dhe bashkëpunimit me të tjerët, të analizës së të dhënave dhe përpunimit statistikor për të eksploruar teoritë e ndryshme të zhvillimit të njeriut, për të kuptuar rëndësinë e tyre dhe për të propozuar zgjidhje të mundshme për probleme të ndryshme.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- mjedisi, sjelljet dhe qëndrimet;
- si formohen dhe ndryshohen sjelljet dhe qëndrimet;
- si ndikojmë tek të tjerët dhe sa ndikohemi nga të tjerët;
- pyetësi, intervista, popullata, kampionimi;
- grumbullimi i të dhënave;
- përpunimi i të dhënave;
- tabelat, diagramet,
- interesi financiar, llogaritja e kostos, vlerësimi i zgjidhjeve
- paraqitja grafike e të dhënave;
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

Partnerët që do marrin pjesë në projekt – prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

Burimet kryesore të informacionit:

- Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve (intervistave);
- Biseda me prindër, mësues;
- Materiale nga interneti, biblioteka (nëse është e mundur);

- Literaturë psikologjike;
- Teksti mësimor i psikologjisë për klasën e XII;
- Etj.

Tematika e orëve të planifikuara:


- *Ora 1.* Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës. Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i pyetësorëve (intervistave), përcaktimi i popullatës dhe përzgjedhja e kampionit në të cilën do të kryhet pyetësori (intervistat). Konsulentët që mund të anketohen.
- *Ora 2.* Shpërndarja e pyetësorëve në atë kampion ku është planifikuar të bëhet. Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, (intervistat). Grumbullimi i materialit nga burime të tjera.

Përpunimi i materialit të grumbulluar, përpunimi i të dhënave të marra nga pyetësorët. etj.

- *Ora 3.* Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. Më pas hartimi i draftit përfundimtar të projektit dhe diskutimi i tij.
- *Ora 4.* Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve. Reflektimi.
- *Ora 5.* Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve. Reflektimi.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit. Prezantoni nxënësit me çështje të ndryshme të qëndrimeve dhe sjelljeve të njerëzve në mjedise dhe rrethana të ndryshme në të cilat ata janë gjendur ose mund të gjenden në të ardhmen. Tema të tjera të sugjeruara nga nxënësit. Ndarja e klasës në grupe sipas interesave të nxënësve.
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup. Kërkojuni nxënësve të zgjedhin një sjellje apo qëndrim mbi një çështje të caktuar me interes dhe të kryejnë kërkime për të mbledhur të dhëna dhe informacione përkatëse rreth saj. Ata duhet të marrin



parasysh mjedisin, ndikimet dhe zgjidhjet e mundshme që lidhen me temën e zgjedhur. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit


- Hartimi i pyetësorit (intervistave), përcaktimi i popullatës dhe përzgjedhja e kampionit në të cilën do të kryhet pyetësi (intervistat). Udhëzoni nxënësit për metodat e mbledhjes së të dhënave, të tilla si anketat, intervistat ose bazat e të dhënave në internet, për të mbledhur të dhëna në lidhje me temën.
- Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, (intervistat), komunikimi me mësuesit, prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënësit sipas popullatës së përzgjedhur. Përpunimi i të dhënave. Udhëzoni nxënësit në organizimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura duke përdorur teknika statistikore sasiore dhe cilësore.
- Ndërtimi i tabelave, diagrameve etj. Inkurajoni nxënësit të krijojnë paraqitje vizuale të të dhënave të tyre, si grafikët, infografikët për të komunikuar në mënyrë efektive gjetjet e tyre.
- Hartimi i projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale..
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit. Nxënësit përgatisin prezantime për të ndarë kërkimet e tyre, analizën e të dhënave dhe zgjidhjet e propozuara me klasën ose një audiencë më të gjerë.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për trajtimin e çështjes.
- Nxitini nxënësit të reflektojnë mbi të nxënit e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit

Projekti do të përmbajë analizën e ndikimit të mjedisit në sjelljet e qëndrimeve të njerëzve për çështje të caktuara në momente të ndryshme. Për të realizuar këtë projekt nxënësit do të mbledhin informacione që lidhen me detyrën hulumtuese që ka secili grup. Detyra hulumtuese ka të bëjë me studimin e një mjedisi të caktuar dhe si e sa ndikon ky mjedis në sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve në përgjithësi dhe individëve të veçantë.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- 
- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer për ndikimin e mjedisit në formimin e qëndrimeve dhe sjelljeve.
 - ***Analiza dhe interpretimi i të dhënave:*** Saktësia dhe përshtatshmëria e teknikave të përdorura për të analizuar të dhënat e mbledhura.
 - ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
 - ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e analizës, vlerësimi i zgjidhjeve të mundshme dhe reflektimi mbi veprimet personale të ndërmarra.
 - ***Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit,*** individualisht dhe në progresin e grupit.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese.	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme.
Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë	Nxënësit ndonjëherë	Nxënësit zakonisht	Nxënësit përdorin gjatë gjithë

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>përdorin teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre.</i> <i>Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

